



Qeveria e Republikës së Maqedonisë së Veriut

STRATEGJIA PËR KOMUNIKIM

2019/2020



VIZIONI

Maqedonia e Veriut është shoqëri, në të cilën komunikimet e institucioneve përkushtohen plotësisht ndaj interesit publik dhe në cilën ekziston nivel i lartë i besimit midis qytetarëve dhe institucioneve



MISIONI

Informim i qartë dhe në kohë i të gjithë qytetarëve përmes kanaleve të ndryshme të komunikimit për shërbimet dhe politikat e Qeverisë dhe vendosje e mekanizmave për komunikim të dyanshëm ndërmjet qytetarëve dhe institucioneve

PËRMBAJTJA

FJALË HYRËSE	4
REZYME EKZEKUTIVE	5
PLANI I KOMUNIKIMIT NË PESË TEMA	7
1. NE JEMI NATO, SHKOJMË NË BE	8
1.1. VEND STABIL DHE I SIGURTË – NE JEMI NATO	9
1.2. PËRMES REFORMAVE DERI NË VLERA EVROPIANE – SHKOJMË DREJT BE	10
1.3. INTEGRIMET SJELLIN INVESTIME	12
2. EKONOMI E FUQISHME - MUNDËSI PËR TË GJITHË	14
2.1. MË TEPËR PARA TE QYTETARËT	15
2.2. VENDE PUNE TË REJA DHE MË MIRË TË PAGUARA	17
2.3. MBËSHTETJE PËR KOMPANITË, TRAJTIM I BARABARTË I KOMPANIVE TË VENDIT DHE TË HUAJA	17
2.4. INVESTIME KAPITALE	18
3. SHTET PËR QYTETARËT - INVESTOJMË NË NJERËZIT, KUJDESEMI	20
3.1. JETESË DINJITOZE	21
3.2. POLICIA – MIK DHE MBROJTËS I QYTETARËVE	22
3.3. SHËRBIMI MË AFËR TEJE	22
3.4. INVESTOJMË PËR NJË AMBIENT JETËSOR MË TË MIRË	23
3.5. FËMIJËT DHE TË RINJTË JANË MË TË RËNDËSISHËM	24
3.6. KUJDES PËR PACIENTËT DHE SPITALE BASHKËKOHORË	25
4. NJË SHOQËRI, E DREJTË DHE E BARABARTË	26
4.1. MOS-DISKRIMINIM DHE MUNDËSI TË BARABARTA	27
4.2. ZHVILLIM I BARABARTË INKLUZIV DHE INTERKULTURË	29
4.3. BARAZI GJINORE DHE LUFTË KUNDËR DHUNËS SË BAZUAR NË GJINI	30
5. QEVERI E HAPUR NË SHËRBIM TË QYTETARËVE	32
5.1. INSTITUCIONE TRANSPARENTE DHE LLOGARIDHËNËSE	33
5.2. PROFESIONALIZIM DHE DEPARTIZIM I ADMINISTRATËS PUBLIKËS	34
5.3. LUFTË KUNDËR KORRUPSIONIT	34
5.4. LIRIA E SHPREHJES	34
SISTEMI PËR KOMUNIKIM I QEVERISË SË REPUBLIKËS SË MAQEDONISË SË VERIUT – CILAT JANË QËLLIMET, FUNKSIONET TONA DHE SI JEMI TË ORGANIZUAR?	36
MATRICA PËR PLANIFIKIM TË KOMUNIKIMEVE TË QEVERISË	38
PLANIFIKIMI I KOMUNIKIMEVE PËRMES MODELIT OASIS	39
PROFESIONALIZIMI I KOMUNIKIMEVE QEVERTARE NË VITIN 2019 DHE 2020	42
INTERESI PUBLIK DHE KOMUNIKIMET QEVERTARE	43
KODI I SJELLJES I NËPUNËSVE QEVERTAR PËR MARRËDHËNIE ME OPINIONIN	45

FJALË HYRËSE



Të nderuar qytetarë, kolegë ministra nga Qeveria, të dashur këshilltarë dhe nëpunës për marrëdhënie me opinionin,

Qeveria e Republikës së Maqedonisë së Veriut inicioi dhe zbaton program ambicioz për reforma politike dhe demokratike për ta kthyer besimin e qytetarëve në institucionet e sistemit. Për t'u ndërtuar ai besim është e nevojshme që institucionet të komunikojnë me qytetarët dhe me përfaqësuesit e mediave në mënyrë të sigurtë, objektive dhe në kohë.

Ne si institucion qendror ekzekutiv u zotuem se në punën tonë, e posaçërisht në fushën e komunikimit do të jemi qeveri e hapur. Kështu, që nga dita e parë i hapëm gjerësisht dyert e Qeverisë për gazetarët, kameramanët dhe foto-reporterët, e kështu edhe vazhdojmë në publikimin e përditshëm të të dhënave, dokumenteve dhe informacioneve në interes të opinionit.

Kjo Qeveri u përcaktua për ngritje të zërit, e jo për heshtje. Duhet të ketë zëshmeri dhe ne jemi krenarë që marrim pjesë në krijimin e atij ambienti. Ngritja e zërit u mundëson mediave profesionale dhe të pavarura ta shprehin qëndrimin e qytetarëve dhe interesin e opinionit në një shtet demokratik. Dhe kjo Qeveri e hapur dhe demokratike e dëgjon zërin e qytetarëve të saj për t'u përmirësuar dhe për të mbetur konsekuente në prioritetet e përcaktuara.

Prandaj, përmes këtij plani për komunikim, i sjellim politikat e Qeverisë afër qytetarëve. Zhvillojmë komunikime proaktive qeveritare, me ç'rast bashkë me qytetarët kontribuojmë në ndërtimin e Maqedonisë së Veriut si vend, i cili është pjesë e botës demokratike globale, me ekonomi të fuqishme, e cila ofron shans për çdo qytetar, shtet i cili kujdeset dhe investon në njerëzit e vet, për shoqëri të drejtë dhe të barabartë, shtet të udhëhequr nga një qeveri e hapur.

Sot jam i lumtur dhe krenar që të gjithë mund të mbështetemi në këtë dokument strategjik, me të cilin definojmë standarde të komunikimit të hapur midis Qeverisë dhe opinionit. Zhvilluam sistem demokratik për marrëdhënie me opinionin, një koncept tërësisht të ri për transparencë dhe llogaridhënie të institucioneve qeveritare, si dhe kulturë të re të diskutimit kritik dhe të lirë publik në hapësirën mediatike. Kjo është liria dhe demokracia.

Për në fund fjalës sime hyrëse për Strategjinë e Komunikimit të Qeverisë, të gjithë qytetarëve u dëshiroj që të mbeten të përkushtuar në dhënien e kontributit në ndërtimin e shoqërisë së përbashkët, të drejtë dhe demokratike, ndërsa kolegëve në Qeveri u falënderoj për punën dhe përkushtimin për hapjen e institucioneve dhe i porosis se na pret edhe shumë angazhim, sepse atë e kërkojnë dhe e presin qytetarët. Gjithashtu, falënderoj Qeverinë e Mbretërisë së Bashkuar, USAID-in dhe Institutin për Studime të Komunikimit për përkrahjen në krijimin e këtij dokumenti strategjik dhe në krijimin e shërbimit profesional për komunikim të Qeverisë.

Robert Popovski

Ministër pa portofol i ngarkuar për komunikime, llogaridhënie dhe transparencë në Qeverinë e Republikës së Maqedonisë së Veriut

REZYME EKZEKUTIVE



Të nderuar qytetarë, të nderuar kolegë,

Përpara jush është dokument, i cili është rezultat i angazhimit pothuajse dyvjeçar dhe bashkëpunimit të nëpunësve qeveritar për marrëdhënie me opinionin, të cilët në pajtim me përcaktimin e Qeverisë për të qenë e hapur, u angazhuan në krijimin e një sistemi për komunikime të qeverisë i cili është i organizuar dhe i cili, para së gjithash, është demokratik dhe shërbyes.

Sot, qytetarët, në shërbim të tyre dhe në shërbim të interesit publik kanë pres shërbim qeveritar, të përbërë nga sektorët për marrëdhënie me opinionin të Qeverisë dhe të ministrive, detyra themelore e të cilëve është të përgjigjen në pyetjet e mediave, t'i shpjegojë masat dhe politikat nga Programi për Punë të Qeverisë, ta sigurojë llogaridhënien e institucioneve dhe ta përmirësojë imazhin e Maqedonisë së Veriut jashtë kufijve të vendit.

Ky koncept i transparencës dhe orientimi shërbim dhënës i PR-it të Qeverisë nuk ishte i trashëguar, e as që mund të gjendej në

protokollet institucionale për punë të Qeverisë deri në vitin 2017. E ndërtoam nga themeli, me përkrahje të madhe të kryetarit të Qeverisë së Maqedonisë së Veriut, Zoran Zaev dhe me gatishmëri dhe përkushtim të ministrave dhe të komunikuesve qeveritar.

Zëri i opinionit na ndihmoi shumë që të ndërtojmë kapacitete komunikimi, të cilat bazohen në vlera demokratike, siç janë kuptimi i kritikës, llogaridhënia, shërbyeshmëria dhe liria. U lidhëm në rrjet të brendshëm për të arritur vendosje precize organizative, e cila është e përshkruar në këtë dokument. Zhvilluam plan për zhvillim profesional, standarde për komunikime me interes publik dhe kod për komunikuesit qeveritar. Sipas këtyre standardeve, marrëdhëniet qeveritare me opinionin edhe në mënyrë praktike edhe atë zyrtare, radhiten sipas rregullave të komunikimit etik, të përgjegjshëm dhe profesional.

Në punën tonë, ne udhëhiqemi nga interesi publik dhe nga vizioni ynë për të siguruar nivel të lartë të besimit midis qytetarëve dhe institucioneve. Me këtë rast, pengesë më e madhe në rrugën drejt arritjes së besimit të dëshiruar janë dezinformatat si dhe krijimi dhe përhapja e organizuar e manipulimeve. Ne jemi tërësisht të vetëdijshëm për këto sfida dhe do t'i investojmë të gjitha kapacitetet të sistemit tonë të organizuar që të kundërvihemi dhe ta zvogëlojmë dëmin, të cilin lajmet e rreme e shkaktojnë mbi interesin publik.

Të gjithë kolegëve u dëshirojmë profesionalizëm dhe sukses në punë, ndërsa, para së gjithash, obligohemi para qytetarëve se do ta hapim edhe më tepër Qeverinë, në pajtim me pritjet e tyre.

Marjan Zabranec

Këshilltar i posaçëm për marrëdhënie me opinionin i kryetarit të Qeverisë së Republikës së Maqedonisë së Veriut



1

**NE JEMI NATO,
SHKOJME NË BE**



2

**EKONOMI E FUQISHME -
MUNDËSI PËR TË GJITHË**



3

**SHTET PËR QYTETARËT -
INVESTOJMË NË NJERËZIT,
KUJDESEMI**




4

**NJË SHOQËRI,
E DREJTË DHE E BARABARTË**



5

**QEVERI E HAPUR NË SHËRBIM
TË QYTETARËVE**



PLAN PËR KOMUNIKIM NË PESË TEMA

Ky është Plani i parë i miratuar për komunikime të Qeverisë së Maqedonisë së Veriut. Ai është i përgatitur me qëllim që t'u ndihmojë komunikuesve qeveritar që t'i kuptojnë më mirë prioritetet qeveritare për periudhën e viteve 2019-2020 dhe t'i transmetojnë në mënyrë më efektive vizionet dhe planet e Qeverisë ndaj qytetarëve.

Edhe më me rëndësi, Plani është i mbështetur me standardet profesionale dhe etike për komunikimet qeveritare dhe shkathtësitë të cilat duhet t'i posedojnë nëpunësit qeveritar që punojnë në pjesën e komunikimeve.

Plani për komunikim bazohet në pesë tema kryesore, mbi të cilat bazohen politikat qeveritare:

1 | **NE JEMI NATO, SHKOJMË NË BE**

2 | **EKONOMI E FUQISHME – MUNDËSI PËR TË GJITHË**

3 | **SHTET PËR QYTETARËT – INVESTOJMË NË NJERËZIT, KUJDESEMI**

4 | **NJË SHOQËRI, E DREJTË DHE E BARABARTË**

5 | **QEVERI E HAPUR NË SHËRBIM TË QYTETARËVE**

Kjo Strategji është vetëm pikënisje dhe realizimi i saj do të varet, si nga komunikuesit qeveritar, ashtu edhe nga të gjithë realizuesit e politikave qeveritare dhe të gjithë nëpunësit që janë në kontakt me qytetarët. Në zhvillimin e këtij dokumenti, Sektori për marrëdhënie me opinionin i Qeverisë së Republikës së Maqedonisë së Veriut bashkëpunonte ngushtë me komunikuesit në çdo ministri, ndërsa prioritetet, qëllimet dhe detyrat e theksuara në dokument janë prodhim i bashkëpunimit të përbashkët ndër-sektorial.



1

**NE JEMI NATO,
SHKOJMË NË BE**

Republika e Maqedonisë së Veriut si partner i barabartë në skenën ndërkombëtare – pjesë e botës prosperuese, demokratike dhe të drejtë, e cila ofron mundësi për të gjithë qytetarët e saj.

PRIORITETE KYÇ

- 1.1. Vend stabil dhe i sigurt – Ne jemi NATO
- 1.2. Përmes reformave deri te vlerat evropiane – Shkojmë drejt BE
- 1.3. Integrimet sjellin investime

1.1. VEND STABIL DHE I SIGURT – NE JEMI NATO!

Filloi gara midis vendeve anëtare të NATO-s për ratifikim të Protokollit për anëtarësi të Maqedonisë së Veriut në Aleancë. Përmeshëm qëllim 27 vjeçar strategjik për vendin tonë, me të cilin garantohej stabiliteti dhe mos cenimi i kufijve, nga ana tjetër, vendi hapet për investime të huaja dhe zhvillim ekonomik.

Qeveria do ta informojë opinionin për procesin e anëtarësimit të vendit në NATO dhe do t'i prezantojë praktikat dhe shembujt e mirë nga vendet anëtarë të NATO-s, me qëllim që t'i sqarojë proceset reformuese që do të burojnë nga anëtarësimi i vendit tonë në NATO dhe t'i afrojnë mundësitë dhe përfitimet nga ato reforma për qytetarët.




1.2. PËRMES REFORMAVE DERI NË VLERAT EVROPIANE – SHKOJMË DREJT BE!

Të gjithë ne, si qytetarë të Republikës së Maqedonisë së Veriut, e ndërmorëm obligimin ta ecim rrugën drejt BE-së, që ta zhvillojmë shtetin tonë në një vend, në të cilin jetohet mirë.

Përgatitemi për fillim të negociatave dhe presim notë pozitive në raportin e ardhshëm të UE me vendim për fillim të negociatave sivjet. Pakoja e reformave të BE-së, të cilat sivjet janë para së gjithash obligim dhe nevojë e vendit, përfshijnë:

- Reforma të administratës publike
- Reformë në gjyqësi
- Reformë në fushën e zbulimit dhe të sigurisë
- Luftë kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar





Përveç kësaj, zhvillimi në më shumë sektorë me qëllim të zhvillimit të standardeve evropiane të jetës për qytetarët, do të përkrahët përmes fondeve të BE-së.

Qeveria e Republikës së Maqedonisë së Veriut do ta informojë opinionin për përgatitjet dhe për procesin e negociatave me BE-së si dhe për zbatimin e pakos së reformave, me qëllim të konsultimit shoqëror dhe afrimit të reformave më afër qytetarëve, si dhe rritjes së dinamikës për zbatimin thelbësor të ndryshimeve të parashtruara.

Qeveria do t'i informojë qytetarët për mundësitë dhe mënyrën e aplikimit për fondet zhvillimore të BE-së në fusha të ndryshme, me qëllim të përdorimit të rritur dhe efektiv të fondeve.



1.3. INTEGRIMET SJELLIN INVESTIME

Stabiliteti i shtetit sjell siguri për investitorët. Investimet e huaja rriten; në vitin 2018 BPRMV shënoi nivel rekord të investimeve të huaja të drejtpërdrejta prej 624,5 milion euro, shumë më e lartë për 267% në raport me mesataren e IHD në periudhën në vitet 2010-2017.

Fokusi është vënë në tërheqjen e kompanive të huaja me shkallë më të lartë të zhvillimit teknologjik, për vende pune të paguara më lartë. Në mandatin e deritanishëm të kësaj Qeverie, në fazë të realizimit janë 18 investime të reja të huaja me paralajmërim për vendime pozitive shtesë, ndërsa dhjetëra të tjerë janë duke shprehur interesim për investime. Këtë vit janë ndarë rreth 10,5 milion euro nga Buxheti i RMV për përkrahje të investimeve të huaja të drejtpërdrejta, për zhvillim teknologjik dhe

produktivitet më të lartë, për njohuri dhe shkathtësi, për nxitje të konkurrencës së tregjeve dhe për përmirësim të bashkëpunimit me kompanitë e vendit.

Qeveria do të komunikojë me investitorë të jashtëm dhe për kushtet për investim në vend përmes tre zyrave rajonale nëpër botë, me qëllim të tërheqjes së investimeve dhe hapje të vendeve të reja të paguara mirë në vendin tonë. Përveç kësaj, do t'i informojmë qytetarët dhe bashkësinë e biznesit për risitë dhe efektet e Zonave Teknologjike – Industriale Zhvillimore (TIRZ) në Republikën e Maqedonisë së Veriut.





INVESTIME TË HUAJA

624,5
milion euro

**INVESTIME
TË HUAJA
TË DREJTPËRDREJTA**

18

**INVESTIME
TË HUAJA
TË REJA**

10,5
milion euro

**mbështetje
të investimeve
të huaja
të drejtpërdrejta**





2

**EKONOMI E FUQISHME –
MUNDËSI PËR TË GJITHË**

Krijimi i ekonomisë së fuqishme dhe të drejtë, e cila e nxit rritjen, krijon vende të punës dhe i përkrah ata që janë më të lëndueshëm.

PRIORITETE KYÇ

- 2.1. Më tepër para te qytetarët
- 2.2. Vende pune të reja dhe më mirë të paguara
- 2.3. Mbështetje për kompanitë, trajtim i barabartë i kompanive të vendit dhe ato të huaja
- 2.4. Investime kapitale

2.1. MË TEPËR PARA TE QYTETARËT

Qeveria e Republikës së Maqedonisë së Veriut do të realizojë komunikime publike, me të cilat do t'ua afrojnë qytetarëve dhe kompanive masat për Kthim të 15% TVSH ndaj qytetarëve dhe kthim të TVSH ndaj kompanive.

Qeveria do të informojë rregullisht për politikat e rritjes së pagës mesatare, për rritjen e re të pagës minimale, si dhe për rritjen e pagave në shëndetësi, arsim, mbrojtjen fëmijërore dhe sociale, në mbrojtje.



Qeveria do ta promovojë reformën sociale dhe politikën, e cila ka për qëllim t'i nxjerrë qytetarët nga varfëria dhe ta aktivizojë tregun e punës.

#СеГрижиме 

За солидарна и праведна Македонија

**СОЦИЈАЛНАТА РЕФОРМА
КАЈ 4 ЧЛЕНО СЕМЕЈСТВО**

2 возрасни и
2 деца во основно образование



6.800	Гарантирана минимална помош
500	Енергетски додаток
1.900	Детски додаток
+ 1.400	Образовен додаток
10.600	(Претходно: 3029 денари)

Qeveria e Republikës së Maqedonisë së Veriut do t'i informojë qytetarët për masat për pushim vjetor të subvencionuar, si dhe për subvencionet për efikasitet energjetik, me qëllim të rritjes së përfshirjes së shfrytëzuesve dhe përkrahjes së turizmit dhe ambientit jetësor në vend.

**ОБЈАВЕНИ СЕ ЈАВНИТЕ ОГЛАСИ
ЗА НАДОМЕСТУВАЊЕ НА ДЕЛ ОД
ТРОШОЦИТЕ ЗА КУПЕНИ И ВГРАДЕНИ
СОНЧЕВИ КОЛЕКТОРСКИ СИСТЕМИ И ЗА
ПВЦ ИЛИ АЛУМИНИУМСКИ ПРОЗОРЦИ
ВО ДОМАЌИНСТВОТА ЗА 2019 ГОДИНА,
ЗА КОИ СЕ ОБЕЗБЕДЕНИ
25 МИЛИОНИ ДЕНАРИ.**



Informacione të rregullta do të marrin edhe bujqit, posaçërisht për masat që kanë të bëjnë me zvogëlimin e shpenzimeve (nafta e gjelbër, kthim i tatimit personal në të ardhura) dhe subvencionet, të cilat shërbejnë si përkrahje për modernizim dhe rritje të prodhimtarisë bujqësore.



2.2. VENDE PUNE TË REJA DHE MË MIRË TË PAGUARA

Qeveria do të realizojë fushatë, me të cilën do t'i informojë qytetarët dhe kompanitë për politikën për hapje të vendeve të reja dhe të paguara mirë përmes Planit Operativ për Punësim 2019 dhe Planit për Rritje Ekonomike – Ligji për përkrahje financiare të investimeve.

Resorët ekonomik në Qeverinë e Republikës së Maqedonisë së Veriut do të informojnë rregullisht për aktivitetet e ndërmarra nga Qeveria në lidhje me uljen e papunësisë.



2.3. PËRKRAHJE PËR REFORMAT, TRAJTIM I BARABARTË I KOMPANIVE TË VENDIT DHE TË HUAJA

Qeveria e Republikës së Maqedonisë së Veriut do t'ua afrojë qytetarëve dhe kompanive masat për përkrahje të investimeve, për rritje të eksportit dhe përmirësim të konkurrencës, për përkrahje të kompanive të vogla, të mesme dhe mikro, të inovacioneve dhe start-up kompanive nga Plani për rritje ekonomike dhe nga Programi për konkurrencë, inovacione dhe sipërmarrësi.



2.4. INVESTIME KAPITALE – ENERGJI E PASTËR DHE RRUGË TË SIGURTA

The Government of the Republic of North Macedonia will be informing the citizens and the companies about strategic capital projects related to road, railway and energy connectivity in order to provide fast, secure and competitive transport and flow of people, goods and products, regional connectivity, gasification and conquering of new markets – as a solid basis for rapid development of the economy.





**TRAJTIM I BARABARTË I KOMPANIVE
TË VENDIT DHE TË HUAJA**

A young child, seen from the back, is holding a flag with a sunburst design. The child is wearing a light-colored t-shirt and dark pants. The background is a blurred crowd of people, suggesting a public event or ceremony. The entire image has a purple tint.

3

**SHTET PËR QYTETARËT –
INVESTOJMË NË NJERËZIT,
KUJDESEMI**

Ndërtojmë shtet, të cilin gjeneratat e ardhshme do të jenë krenare ta quajnë shtëpi të veten.


PRIORITETE KYÇ

- 3.1. Jetë dinjitoze
- 3.2. Policia mik dhe mbrojtës i qytetarëve
- 3.3. Shërbimi më afër teje
- 3.4. Investojmë për ambient më të mirë jetësor
- 3.5. Fëmijët dhe të rinjtë janë më të rëndësishëm
- 3.6. Kujdes për pacientët dhe spitalet bashkëkohore

3.1. JETË DINJITOE

Qytetarët dhe kompanitë do të informohen për politikën e re të drejtë ndëshkuese, me të cilën zvogëlohen dënimet në drejtim të përshtatjes së tyre me standardin jetësor – deri në 70% më pak për qytetarët dhe deri 60% më pak për kompanitë, si dhe do të realizohen komunikime, me të cilat do të promovohet zvogëlimi i shpenzimeve përmbarese dhe noteriale për 50% deri në 90%.

Komunikimi do të fokusohet edhe në ngritjen e vetëdijes dhe të informimit të grupeve të lëndueshme për shfrytëzim të ndihmës juridike falas me qëllim të mbrojtjes më të madhe të të drejtave të grupeve të lëndueshme. Përveç kësaj, do të realizohet fushatë për informim të kategorive të lëndueshme dhe të kompanive për ndryshimin e tarifës së përmbarrimit dhe të tarifave noteriale me qëllim të njohjes së tyre me të drejtat e tyre dhe mbrojtjes së dinjitetit, përmes përshtatjes së dënimeve sipas standardit jetësor.



3.2. POLICIA MIK DHE MBROJTËS I QYTETARËVE

Përmes fushatave publike, do t'i informojmë qytetarët për vendosjen e policëve - vrojtues në lagje, me të cilët rritet siguria dhe besimi midis qytetarëve dhe policisë.



3.3. SHËRBIMI MË AFËR TEJE

Institucionet punojnë në mënyrë intensive që t'u sigurojnë qytetarëve më pak kohë të kaluar në sportel, shërbim të shpejtë dhe të digjitalizuar të qasshëm në çdo shtëpi, dhe besim të shtuar ndaj shërbimeve shtetërore.

Qeveria e Republikës së Maqedonisë së Veriut do t'i informojë qytetarët për hapje të qendrave "Një Pikë për Shërbime", për afatet e shkurtuara për dhënie të dokumenteve me dërgim deri në shtëpi dhe për aplikim të një pikë për kontroll të kufijve, me çka do të sigurohet zvogëlimi i kohëzgjatjes në të cilën qytetarë të marrin shërbimin.



Do të zhvillojmë një fushatë edukative për qytetarët dhe pjesëmarrësit e trafikut, në të cilën do t'i informojmë për shërbimet elektronike dhe digjitale që mund të merren nga institucionet.

Opinionit do të informohet edhe për ndërtimin e rrugëve të reja si dhe për rikonstruktimin e rrjetit ekzistues rrugor në vend, me qëllim që qytetarët, komunat dhe ekonomia të kenë lidhshmëri më të mirë, komunikim më të lehtë, transport të shpejtë dhe të sigurt të mallrave dhe të shërbimeve. Do t'i informojmë qytetarët dhe ekonominë për ndërtim të hekurudhave të reja, përmes të cilave lidhemi me fqinjët në mënyrë hekurudhore, qytetarëve u mundësojmë drejtime të reja, ndërsa kompanive konkurrencë më të madhe dhe pushtim të tregjeve të reja.

Në mënyrë të vazhdueshme do të informojmë

popullatën lokale për ndërtim të stacioneve të pastrimit dhe trajtimit të ujërave mbetëse, me të cilat sigurohen lumenj të pastër, mbrojtje e truallit dhe mbrojtje e ujërave nëntokësore/bunarëve, si dhe higjienë urbane, por edhe për ndërtim të deponive rajonale, të cilat do ta rrisin cilësinë e jetës, mbrojtjen e ambientit jetësor dhe zhvillimin e qëndrueshëm të komuniteteve.

Do t'i informojmë qytetarët nga mjediset rurale për mundësinë për shërbim shëndetësor dhe përkujdesje në shtëpi nga shërbimet patronazhe. Do të realizohet edhe fushatë informative për pacientët dhe mjekët për reformat dhe mundësitë gjatë fuqizimit dhe zgjerimit të mbrojtjes primare shëndetësore, me qëllim të sigurimit të më tepër shërbimeve shëndetësore për pacientët.



3.4. INVESTOJMË NË AMBIENT MË TË MIRË JETËSOR

Do t'i motivojmë dhe mobilizojmë qytetarët, organizatat civile dhe institucionet për t'u siguruar aksion i bashkuar për realizim të Planit për Ajër të Pastër. Do ta informojmë opinionin për sërën e masave për mbrojtje të pasurisë natyrore dhe biodiversitetit, duke siguruar ambient të shëndetshëm jetësor dhe zhvillim të tij të qëndrueshëm për qytetarët.



ОТВОРЕН ДЕН ПЛАН ЗА ЧИСТ ВОЗДУХ

Иницијативи на граѓански организации и временската рамка за спроведување на „Планот за чист воздух“ за 2019-та година



Република Северна Македонија
Влада на Република Северна Македонија

ПЛАН ЗА
ЧИСТ ВОЗДУХ

3.5. FËMIJËT DHE TË RINJTË JANË MË TË RËNDËSISHËM

Qeveria e Republikës së Maqedonisë së Veriut do t'i informojë qytetarët për investimet në mbrojtjen e fëmijëve, në arsimin fillor, të mesëm dhe të lartë dhe shëndetësi, me qëllim të mundësisimit të zhvillimit të hershëm të fëmijëve dhe kapitalit cilësor njerëzor. Do t'i promovojmë avantazhet dhe mundësitë për strehim të fëmijëve pa prindër me qëllim që të sigurohen familje për përkujdesje dhe shtëpi të ngrohta për sa më shumë fëmijë që është e mundur. Qytetarët do të informohen edhe për politikën sociale, me të cilat zgjerohet e drejta për shfrytëzim të shtesës për fëmijë dhe arsimore për mbi 70.000 fëmijë, që synon nxjerrjen e tyre mbi linjën e varfërisë dhe përfshirjen në procesin arsimor.

Qeveria do t'i informojë nxënësit dhe prindërit e tyre për përdorimin e metodave të reja digjitale të mësimin dhe për fitimin e shkathtësive në sistemin arsimor, për modernizimin e shkollimit të mesëm profesional dhe kontrollin e cilësisë në arsimin e lartë.



Qeveria do ta promovojë Kartelën Rinore Evropiane në Maqedoninë e Veriut, me të cilën të rinjtë do të mund të fitojnë mijëra shërbime nga kompani dhe institucione të ndryshme në vend dhe në Evropë me çmime preferenciale dhe më të ulëta si dhe me çmime solidarë.

Qeveria do t'i informojë mjekët e rinj të ardhshëm dhe personelin aktual mjekësor për investimet në kuadrin mjekësor të vendit, rritjen e pagave dhe përmirësimin e kushteve për punë me qëllim që punëtorët e rinj shëndetësor të mbeten këtu dhe të sigurojnë mbrojtje shëndetësore për qytetarët.



3.6. KUJDES PËR PACIENTËT DHE SPITALE BASHKËKOHORE

Do të vazhdojmë me zbatimin e komunikimit për imunizim dhe për bazën e zgjeruar të barërave për sëmundje të rralla, për ta ngritur imunitetin kolektiv dhe për të siguruar terapi në kohë për ata që kanë nevojë për atë.

Qeveria do t'i informojë qytetarët për përgatitjet dhe fillimin e ndërtimit të qendrës së re klinike, si dhe për ndërtimet në vazhdim, rikonstruktivet dhe pajimet e enteve bashkëkohore shëndetësore.

Qeveria do t'ua afrojë qytetarëve përfitimet nga ligji i ri për ndërprerje të shtatzënisë.



Донесен е новиот
Закон за прекинување
на бременоста.

ВОЛЈАТА НА ЖЕНАТА
НА ПРВО МЕСТО!





4

**NJË SHOQËRI,
E DREJTË DHE E BARABARTË**

Qeveria e Republikës së Maqedonisë së Veriut, e udhëhequr nga nevoja për integrim të brendshëm dhe kohezion midis bashkësive dhe kulturave të ndryshme në shoqërinë tonë, si dhe për implementimin e rekomandimeve nga Këshilli i Evropës të vëna në pah në raportin e fundit të Komisionit Evropian të datës 17.4.2018, e ka veçuar politikën për "Një Shoqëri" si një nga shtyllat e saj qenësore. Qëllimi është ta zhvillojmë vendin tonë si një shoqëri të drejtë dhe të barabartë multikulturore, e cila kujdeset për dallimet, i përkrah të drejtat universale dhe siguron qasje të barabartë në shërbimet dhe mbrojtje për të gjithë qytetarët.

PRIORITETE KYÇ

4.1. Mos-diskriminimi dhe mundësi të barabarta

4.2. Zhvillim i barabartë inkluziv dhe inter-kulturë

4.3. Barazi gjinore dhe luftë kundër dhunës së bazuar në gjini

4.1. MOS-DISKRIMINIMI DHE MUNDËSI TË BARABARTA

Qeveria do ta informojë opinionin për përfitimet nga Ligji i ri dhe mekanizmat për mbrojtje nga diskriminimi, me qëllim që të sigurohet mbrojtja e të drejtave dhe mundësi të njëjta për të gjithë qytetarët në shoqëri.

Me përfshirjen e bazave të orientimit seksual dhe të identitetit gjinor, Ligji e zgjeron mbrojtjen nga diskriminimi ndaj këtij grupi të qytetarëve. Për herë të parë aplikohet nocioni "segregacion", si dhe mbrojtje dhe parandalim i diskriminimit të personave me aftësi të kufizuara.

Do të raportohet për reformat në arsimin fillor dhe të mesëm me qëllim të rritjes së inkluzionit në sistemin arsimor, posaçërisht për nxënësit me nevoja të posaçme arsimore, nxënësit nga grupet dhe mjediset e margjinalizuara, si dhe fëmijët që nuk kanë qenë të kyçur në arsim. Do të promovohet revizioni i programeve arsimore dhe librave të mësimi sipas konceptit të barazisë dhe mos-diskriminimit.

Qeveria do të informojë për aplikimin e platformave për qasje në institucionet publike dhe kulturore dhe për aplikimin e gjuhës së shenjave në shfaqjet teatrale.



Do të vazhdojmë ta promovojmë edhe procesin e filluar të de-institucionalizimit, përkatësisht të braktisjes të institucioneve jo-institucionale në këmbim për përkujdesje të ngrohtë familjare për fëmijët pa prindër.

Qeveria do të informojë për avancimin e përdorimit dhe aplikimit të gjuhëve që i flasin qytetarët e Republikës së Maqedonisë së Veriut, në pajtim me Ligjin e ri për përdorim të gjuhëve. Qeveria do ta promovojë edhe aplikimin në arsim si lëndë zgjedhore të gjuhës dhe kulturës të Romëve, Boshnjakëve dhe Vllehëve, si dhe fuqizimin e programit të mësimin të gjuhës maqedonase në diasporë, me rritje të numrit të arsimtarëve. Qeveria do të vazhdojë t'i promovojë mbrojtjen dhe avancimin e gjuhës maqedonase të cilën e flasin qytetarët në Maqedoninë e Veriut dhe në diasporë.

Në kuadër të Strategjisë Nacionale për Bashkëpunim me Diasporën, Qeveria do të raportojë për të gjitha aktivitetet për bashkëpunim të shtetit me diasporën, për kyçjen e saj politike, për realizimin e të drejtave të saja qytetare dhe sociale, për vendosje të lidhjeve kulturore dhe ruajtje të identitetit kulturor dhe trashëgimisë kulturore të diasporës.



4.2. ZHVILLIM I BARABARTË INKLUZIV DHE INTER-KULTURË



Qeveria e Republikës së Maqedonisë së Veriut do ta informojë opinionin për projektet në kuadër të Programit për Zhvillim të Barabartë, i cili përmes përkrahjes financiare të rajoneve planëzuese dhe komunave, ka për qëllim të zhvillojë qasje më të mirë të barazuar në shërbimet për të gjithë qytetarët në pajtim me nevojat e tyre, pa dallim nëse jetojnë në komuna urbane ose rurale, pa dallim të përkatësisë etnike, fetare dhe gjinore, të statusit social ose gjendjes, në të cilën gjenden.

Përveç kësaj, Qeveria do të informojë edhe për mekanizmat që i zhvillon për nxitje të pjesëmarrjes qytetare në përcaktimin dhe realizimin e prioriteteve për zhvillim lokal dhe rajonal, me qëllim që të sigurohet informimi, parashikueshmëri dhe pjesëmarrje më e madhe qytetare në nivel lokal. Qeveria do ta promovojë edhe decentralizimin dhe demonopolizimin në kulturë që zbatohet përmes zhvillimit sistematik, planifikimit, financimit dhe realizimit të programeve kulturore me qëllim të dyfishtë:



qasshmëri në përmbajtjet kulturore nga “metropoli” në brendësi dhe anasjelltas, si dhe prani më e madhe e përmbajtjeve kulturore nga brendësia në kryeqytet. Qeveria do të raportojë për procesin e rikonstruktimit, sanimit dhe adaptimit të objekteve të Institucioneve Nacionale – në vitin 2019 planifikohet rikonstruktimi i më tepër objekteve nga fusha e kulturës në fusha të ndryshme të vendit, me qëllim që të sigurohet zhvillimi i barabartë dhe inkluziv i kulturës në tërësi në mbarë territorin e Republikës së Maqedonisë së Veriut dhe që përmbajtjet artistike t’i afrojë deri te sa më tepër qytetarë që është e mundur.



Qeveria do t’i promovojë mundësitë dhe përmbajtjet e “Valës së re kulturore”, përmes së cilës ofrohen mekanizma për aktivizim të skenës së pavarur kulturore. Konkursi ka për qëllim t’i promovojë dhe t’i stimulojë autorët dhe projektet që kanë karakter multimedial dhe interdisciplinar, e në të njëjtën kohë t’i inkurajojë që të jetësohen edhe disa objekte dhe hapësira të braktisura, si dhe të përkrahë projekte të vogla mobile në mjediset lokale në bashkëpunim me shoqatat dhe individët nga sektori joqeveritar dhe institucionet lokale kulturore.



4.3. BARAZI GJINORE DHE LUFTA KUNDËR DHUNËS SË BAZUAR NË GJINI

Qeveria e Republikës së Maqedonisë së Veriut do ta informojë opinionin për implementimin e Strategjisë për Barazi Gjinore me qëllim të arritjes së pjesëmarrjes së barabartë të grave në shoqëri. Do të informohet për Ligjin për marrëdhënie pune, me të cilin jepet pjesëmarrje e barabartë e grave dhe të burrave në tregun e punës, si dhe për revizionin e përmbajtjeve të programeve arsimore nga aspekti i avancimit të mundësive të barabarta të grave dhe të burrave.



Qeveria do ta promovojë edhe procesin e përgatitjes dhe miratimit të zgjidhjes ligjore për dhunën e bazuar në gjini, për t'u siguruar pengimi dhe mbrojtja nga të gjitha llojet e dhunës ndaj grave dhe vajzave, përfshirë edhe dhunën familjare. Në të njëjtën kohë, opinionin do të informohet edhe për hapje të shellter-qendrave të reja edhe për ato që janë në funksion, si dhe për SOS telefonin për të ngritur vetëdijen e shoqërisë që të paraqesin dhunën. Opinionin do të informohet edhe për aplikimin e standardeve në arsimin fillor, me të cilët do të synohet zvogëlimi i dhunës së moshatarëve në shkolla.



Për herë të parë prezantohet termi "segregacion", si dhe mbrojtja dhe parandalimi i diskriminimit të personave me aftësi të kufizuara



"VALË E RE KULTURORE"

Konkursi ka për qëllim nxitjen dhe stimulimin e autorëve dhe projekteve që kanë një karakter multimedial dhe ndërdisiplinor, ndërsa në të njëjtën kohë inkurajon të ringjallen disa objekte dhe hapësira alternative të braktisura, si dhe të mbështet projektet e vogla mobile



5

**QEVERI E HAPUR NË SHËRBIM
TË QYTETARËVE**

Punojmë në transformim të qeverisë dhe institucioneve të mbyllura në të hapura, ndërsa administratën shtetërore e depolitizojmë dhe e profesionalizojmë. Institucione transparente dhe llogaridhënëse, bashkë me medie profesionale dhe të pavarura, mund ta kundërshtojnë fuqishëm korrupsionin dhe të sigurojnë shërbime profesionale për qytetarët.

PRIORITETE KYÇ

5.1. Institucione transparente dhe llogaridhënëse

5.2. Profesionalizim dhe departizim
i administratës publike

5.3. Luftë kundër korrupsionit

5.4. Liri e shprehjes

5.1. INSTITUCIONE TRANSPARENTE DHE LLOGARIDHËNËSE

Qeveria e Republikës së Maqedonisë së Veriut do të vazhdojë në mënyrë proaktive të publikojë informacione dhe dokumente të lidhura me punën e institucioneve dhe do ta rrisë numrin e institucioneve që do të transformohen nga të mbyllura në të hapura. Do të rritet vëllimi edhe i Të Dhënave të hapura, të cilat publikohen rregullisht në portalin e ri për të dhëna të hapura. Qeveria do të vazhdojë t'i publikojë shpenzimet e bartësve të funksioneve publike, ndërsa do të publikohen edhe shpenzimet e institucioneve. Do të promovohen mundësitë nga ndryshimet e

Ligjit për qasje të lirë në informacione me karakter publik, në drejtim të rritjes së reagueshmërisë (përgjigjshmërisë) së institucioneve dhe lehtësim të qasjes së qytetarëve në informacionet publike.

Përmes Strategjisë për transparencë, Qeveria në mënyrë sistematike do t'i vendosë standardet e Qeverisë së hapur dhe do të sigurojë qëndrueshmëri në procesin e reformimit të institucioneve.



5.2. PROFESIONALIZIM DHE DEPARTIZIM I ADMINISTRATËS PUBLIKE

Qeveria në mënyrë aktive punon në profesionalizimin dhe departizimin e administratës publike, si dhe në luftën e përforcuar me qëllim të çrrënjësjes së nepotizmit në institucione.

Opinionit do të jetë i informuar për të gjitha risitë, të cilat burojnë nga analiza horizontale funksionale e administratës, nga Ligji i ri për shërbim të lartë-udhëheqës, nga ndryshimet e

Ligjit për nëpunës administrativ, si dhe të Ligjit për të punësuarit në sektorin publik.

Qeveria do ta promovojë konceptin për mënyrë transparente të zgjedhjes së drejtorëve dhe të sekretarëve shtetërorë, të cilët do të kenë kompetencë më të madhe dhe përvojë në kuadër të të paraqiturve, në vend të drejtorëve sipas përkatësisë partiake. Do të promovohet shlyerja e një pjese të këshillave drejtues dhe mbikëqyrës në institucione.

5.3. LUFTA KUNDËR KORRUPSIONIT


Qeveria do të udhëheq komunikim aktiv publik kundër korrupsionit, duke i përkrahur zgjidhjet institucionale të cilat burojnë nga Ligji i ri për pengim të korrupsionit dhe nga puna e Komisionit të reformuar shtetëror për pengim të korrupsionit. Qeveria do ti ftojë qytetarët që ta kundërshtojnë korrupsionit duke i shfrytëzuar mekanizmat për paraqitje dhe parandalim.



5.4. LIRIA E SHPREHJES

Qeveria përmes komunikimeve publike do të vazhdojë ta përkrah hapësirën e pavarur mediatike, të liruar nga ndikesa politike. Qeveria publikisht do të angazhohet për liri të shprehjes, por edhe për pengim të përhapjes së dezinformatave dhe të gjuhës së urrejtjes me qëllim që qytetarët të jenë të informuar saktë dhe në kohë dhe në mënyrë aktive të marrin pjesë në ndryshimet shoqërore.

Do të promovohen risitë nga Ligji për shërbime audio dhe audiovizuale, me të cilat do të reformohet Radio Televizioni Nacional dhe do të raportohet në mënyrë transparente për zgjidhjet sistimore për përkrahje të mediave dhe të punëtorëve mediatik.



Opinioni do të informohet për të gjitha lajmet që dalin nga analiza funksionale horizontale e administratës



Qeveria do avokojë publikisht për lirinë e shprehjes, por edhe të parandalojë përhapjen e dezinformimit dhe gjuhës së urrejtjes, në mënyrë që qytetarët të informohen në mënyrë të saktë dhe në kohë dhe të marrin pjesë në mënyrë aktive në ndryshimet shoqërore

SISTEMI QEVERTAR PËR KOMUNIKIME – CILAT JANË QËLLIMET, FIUNKSIONET TONA DHE SI JEMI TË ORGANIZUAR?

VIZIONI

Maqedonia e Veriut është shoqëri, në të cilën komunikimet e institucioneve përkushtohen plotësisht ndaj interesit publik dhe në cilën ekziston nivel i lartë i besimit midis qytetarëve dhe institucioneve.

MISIONI

Informim i qartë dhe në kohë i të gjithë qytetarëve përmes kanaleve të ndryshme të komunikimit për shërbimet dhe politikat e Qeverisë dhe vendosje e mekanizmave për komunikim të dyanshëm ndërmjet qytetarëve dhe institucioneve.

FUNKSIONE THEMELORE TË SHËRBIMIT TË KOMUNIKIMIT:

- Të sigurojë komunikim proaktiv dhe reaktiv me mediat
- T'i afrojë prioritetet dhe politikat e Qeverisë më afër qytetarëve
- T'i informojë qytetarët për shërbimet, të cilat institucionet i sigurojnë për ata
- Të zbatojë fushata për të mirën publike dhe me interes publik, me të cilat promovohen vlerat, masat dhe shërbimet për jetë më cilësore të qytetarëve
- Ta informojë popullatën në raste të krizave, fatkeqësive dhe katastrofave
- Të sigurojë transparencë dhe llogaridhënie aktive për punën e institucioneve
- Ta përmirësojë imazhin e vendit jashtë nga kufijtë e tij
- Të sigurojë komunikim të brendshëm të institucioneve me nëpunësit shtetëror
- Të sigurojë kontakt të rregullt me qytetarët (elektronik, me shkrim dhe verbal)

Në Sektorin ekzistojnë departamente më të vogla që kryejnë funksionet e mësipërme, duke përfshirë: Zyrën e zëdhënësit për komunikimin me mediat të cilët përgjigjen në pyetjet me interes publik dhe bën organizimin dhe moderimin e konferencave për shtyp; Shërbimi për shtyp për shkrimin e njoftimeve, kumtesave, tezave, propozimeve për deklarata dhe fjalime; Departamenti për komunikimet digjitale që siguron transparencë aktive të Qeverisë përmes komunikimeve online dhe menaxhon faqen e internetit dhe profilet e Qeverisë në mediat sociale; Ekip produksioni për mbështetje teknike në organizimin e aktiviteteve dhe fotografive dhe video materialeve; Departamenti për monitorim të mediave tradicionale dhe të reja, ekip hulumtues dhe analitik, persona përgjegjës për organizimin e ngjarjeve dhe proceseve, si dhe persona për mbështetje administrative dhe logjistike. Këto ekipe kanë koordinatore, të cilët e përbëjnë një organ koordinues për planifikimin strategjik të komunikimeve proaktive dhe reaktive të Qeverisë.

ЗБОРОТ е ЗБОРИ

100 дена

ВЛАДА ЗА ГРАЃАНИТЕ

Враќање на евтината тарифа на електрична енергија

Започнавме процедура на враќање на евтината дневна тарифа на електричната енергија за сите граѓани



Минимална плата од 12.000 денари

Усвоивме закон за минимална плата од 12.000 денари и рамноправност на работниците во текстилно-кожарската индустрија

1 ГОДИНА ПРОМЕНИ МАКЕДОНИЈА ЗА СИТЕ



ОДГОВОРНО ПРЕД ГРАЃАНИТЕ ДВЕ ГОДИНИ ВЛАДА




MATRICË PËR PLANIFIKIM TË KOMUNIKIMEVE QEVERITARE

Sektori qendror për marrëdhënie me opinionin i Qeverisë është në koordinim të vazhdueshëm me Kabinetin e kryetarit të Qeverisë, kabinetet e zëvendës - kryeministrave të Qeverisë së Republikës së Maqedonisë së Veriut, me departamentet për marrëdhënie me opinionin të ministrive dhe institucioneve në kuadër të Qeverisë, përmes sistemit të matricës për planifikim strategjik të komunikimeve proaktive të Qeverisë, i njohur si GRID sistem, model që përdoret nga sistemi komunikues i Britanisë së Madhe.



Matrica është mjet strategjik për planifikim të komunikimeve javore proaktive drejt opinionit për Qeverinë dhe ministrinë



Matrica është dokument 2 - javor, me të cilin harmonizohen të gjitha lajmet që i prodhojnë institucionet qeveritare, me qëllim arritje të efektit maksimal




Matrica i mundëson Qeverisë ta përcaktojë rendin e ditës për aktivitetet e saj dhe të komunikojë në mënyrë të planifikuar



Ministrat janë paraprakisht të njoftuar me aktivitetet e tërë Qeverisë dhe subjekteve të tjera të rëndësishëm në shoqëri

PLANIFIKIM I KOMUNIKIMEVE PËRMES OASIS MODELIT

OASIS është një varg i hapave në vendosjen e rendit dhe të qartësisë gjatë planifikimit të komunikimeve. Qëllimi është të ndihmohet që procesi i planifikimit të bëhet më rigoroz dhe më konsekuent dhe në të njëjtën kohë të sigurohet se të gjitha komunikimet e qeverisë janë efektive, efikase dhe janë të vlerësuara.





OASIS - Një seri hapash që ndihmojnë në vendosjen e rendit dhe qartësisë gjatë planifikimit të komunikimit

QËLLIMET

Theksoni shkurtimisht çka dëshirohet të arrihet me aktivitetin e komunikimit?

Filloni me qëllimin politik dhe definoni çfarë roli do të kenë komunikimet si përkrahje në realizimin e tij. Qëllimet duhet të jenë të realizueshme, të matshme dhe të fokusohen në rezultatet përfundimtare (outcomes) e jo në rezultatet të cilat do të ishin arritur tani dhe menjëherë (outputs).

AUDIENCA

Për kë është dedikuar komunikimi?

Të kuptuarit të audiencës tonë ka rëndësi qenësore për të pasur komunikime efektive. Përdorni inspektim për të fituar parafytyrim të plotë për atë se cili është publiku i juaj dhe çfarë është ajo që e motivon atë publik.

STRATEGJI/IDE

Cila është qasja e juaj?

Shfrytëzoni inspektimin e audiencës tuaj për ta përcaktuar qasjen, të cilën do ta kenë aktivitetet komunikuese. Cilat do të jenë mesazhet e juaja kyç? Cilat kanale do t'i përdorni për të arritur te publiku juaj në mënyrën më të mirë të mundshme?

IMPLEMENTIMI

Si do t'i realizoni komunikimet?

Theksoni plan real për mënyrën, në të cilën do ta realizoni aktivitetin komunikues, si dhe resurset të cilat i keni alokuar për realizimin e tillë dhe për kornizën kohore.

VLERËSIM

Si do të dini se komunikimet e Juaja kanë qenë të suksesshme?

Është e nevojshme që t'i përcillni rezultatet e arritura tani (outputs) dhe rezultatet përfundimtare (outcomes) gjatë kohës së tërë aktivitetit komunikues, që të mund të bëni ndryshime, me të cilat do të sigurohet realizimi i tij efektiv dhe kontributi ndaj realizimit të qëllimeve fillimisht të planifikuara.



PROFESIONALIZIMI I KOMUNIKIMEVE NË VITIN 2019 DHE 2020

Komunikuesit qeveritar kanë rol të rëndësishëm në informimin e opinionit për punën dhe prioritetet e Qeverisë së Republikës së Maqedonisë së Veriut. Me resurse dhe shkathtësi përkatëse, komunikimet qeveritare mund të bëjnë shumë më tepër – mund ta përmirësojnë jetën e qytetarëve, ta ndërtojnë ekonominë, t'i mbrojnë personat e lëndueshëm dhe ta promovojnë Maqedoninë e Veriut jashtë vendit.

Ne jemi të përkushtuar për përmbushje të vizionit tonë, të arrijmë nivel të lartë të besimit mes qytetarëve dhe institucioneve, përmes ndërtimit dhe angazhimit të bashkësisë së komunikuesve të shkathtë, të informuar dhe profesional qeveritar.

NË VITIN QË VIJON, NE POASHTU, DO TË VENDOSIM THEKS EDHE MBI KOMPONETAT VIJUESE ZHVILLIMORE:

- Ngritje e nivelit të kompetencave profesionale që i posedojnë personat e punësuar si komunikues qeveritar, përmes trajnimeve përkatëse për vendosje të niveleve të përbashkëta të diturisë dhe përvojës së komunikimit te të gjithë komunikuesit e qeverisë
- Përditësimi i strukturave dhe proceseve të komunikimit të Qeverisë dhe ministrive, për t'u garantuar qëndrueshmëri, objektivitet dhe efikasitet i funksioneve të komunikimit dhe të vendoset konsekuencë midis ekipeve
- Avancimi i protokollit për "komunikime të krizës", me të cilin do të sigurohet se Qeveria mund të komunikojë me qytetarët e saj në mënyrë efikase, efektive dhe transparente në kohë të krizës
- Zhvillimi i kapaciteteve tona për identifikim dhe ballafaqim me lajmet e rreme dhe dezinformatat
- Zhvillimi i një sistemi për komunikim të brendshëm përmes administratës shtetërore me qëllim të kuptimit të përbashkët të politikave qeveritare



INTERESI PUBLIK DHE KOMUNIKIMET E QEVERISË

ÇFARË ËSHTË INTERESI PUBLIK?

Edhe pse interesi publik nuk është i përshkruar në mënyrë precize me definicion, e as është rregulluar në mënyrë gjithëpërfshirëse vëllimi i tij, ai paraqitet si kriter shumë i rëndësishëm në legjislativin dhe politikat publike në shtet.

Interesi publik mund të kuptohet si shumë e të drejtave dhe obligimeve, të cilat ndikojnë në tërë popullatën e një shteti. Vëllimi i interesit publik përcaktohet nga shteti përmes së drejtës. Ai përfshin një varg të fushave, të cilat prekin në sfera të ndryshme të shoqërisë dhe në jetën e njeriut, si për shembull: të drejtat e njeriut dhe siguria, rritja ekonomike, standardi jetësor, vlerat kulturore dhe religjioze e të tjera.

Interesi publik është interesi i bashkësisë më të gjerë si tërësi, e cila ka përparësi para nevojave individuale dhe të drejtave të individëve. Kjo zakonisht reflektohet në obligimet të cilat qytetarët duhet t'i përmbushin ndaj shtetit, siç janë pagesa e tatimeve ose respektimi i shenjave të komunikacionit, sepse konsiderohet se respektimi i këtyre rregullave dhe i obligimeve të individëve është në interes më të mirë të qytetarëve. Së këtëjmi, interesi publik mund të shihet si shumë e të drejtave dhe obligimeve të individëve dhe komunitetit ndaj shtetit, si dhe i obligimeve të institucioneve shtetërore për mbrojtje dhe avancim të të drejtave të caktuara të parapara në dispozitat juridike.

PARIMET E KOMUNIKIMEVE QEVERTARE DHE FUSHATAVE QEVERTARE ME INTERES PUBLIK

Relevancë – në pajtim me kompetencat qeveritare, politikat dhe përgjegjësitë prioritare:

Çështje konkrete që duhet të jenë lëndë e publicitetit qeveritar duhet të jenë ato për të cilat Qeveria ka kompetenca të drejtpërdrejta dhe thelbësore. Në mënyrë përkatëse është e nevojshme që Qeveria t'i shpjegojë dhe arsyetojë politikat dhe vendimet e veta dhe, kur ka nevojë, të informojë, këshillojë ose t'ia tërheqë vërejtjen opinionit. Qeveria ka përgjegjësi dhe të drejtë ta shfrytëzojë publicitetin për ta nxitur sjelljen e cila është me "interes publik".



KOMUNIKIM OBJEKTIV DHE INFORMATIV, PAANIM OSE POLEMIKË:

Trajtimi i informacionit duhet të jetë sa është e mundur më objektiv. Informacionet qeveritare ose aktivitetet për publicitet duhet gjithmonë të synojnë drejt informimit të opinionit, madje edhe kur qëllimi është të ndikohet në sjelljen e personave ose të grupeve të caktuara (për shembull: mesazhe për mbrojtje shëndetësore ose për siguri). Duhet të shmangët personalizimi i problemeve ose ndërtimi i imazhit personal.

KOMUNIKIME JO-PARTIAKE:

Nuk është përkatëse të arsyetohen ose mbrohen politikat me shfrytëzimin e mesazheve që janë tipike për partitë politike, të promovohen aktivitete partiake ose drejtpërdrejtë të sulmohen politika dhe mendime të partive opozitare dhe të grupimeve (edhe pse mundet ndonjëherë të jetë e nevojshme t'u përgjigjet të njëjtave në mënyrë konkrete dhe korrekte). Duke e pasur parasysh sistemin politik shumë partiak në Republikën e Maqedonisë së Veriut, është e mundur fushatë e vendosur mirë publike që të krijojnë kredi politike ose dëm për partitë nga pushteti ose nga opozita, por kjo nuk guxon të jetë qëllim as i drejtpërdrejtë e as i tërthortë i informacioneve qeveritare ose i aktiviteteve publike që janë të paguara me mjete publike.



Fushatat informative me interes publik të qeverisë duhet të garojnë për kujdes të opinionit krahasuar me aktivitete të tjera të publicitetit, ndryshe thënë me fushatat e tjera në shoqëri

EKONOMITET, PROPORCIONALITET DHE RACIONALITET:

Shpërndarja e informacioneve me publikun duhet të jetë e organizuar në mënyrë ekonomike dhe përkatëse, ndërsa për shpenzimin e parave publike duhet të informohet në mënyrë transparente. Qeveria është transparente ndaj Parlamentit për atë se në çfarë mënyrë i shfrytëzon resurset publike ose shpenzimet. Fushatat informative me karakter publik të Qeverisë duhet të garojnë për vëmendje nga opinioni me aktivitete të tjera në shoqëri. Për të qenë efektive, ato duhet të jenë të prezantuara në mënyrë profesionale, përkatësisht në mënyrën, me të cilën opinioni merr mesazh të qartë. Me këtë rast, prezantimi i keq mund të thotë shpenzim joefikas të mjeteve publike, duke mos i arritur rezultatet e pritura. Do të kishte qenë kundër produktive nëse shkalla e shpenzimit të mjeteve për fushatë publike e pengon komunikimin e mesazhit që duhet të transmetohet. Nevojitet planifikim i qëllimeve të sakta të komunikimit, të masave dhe sistemeve për vlerësim për çdo komunikim që përfshin shpenzime për resurse me qëllim të sigurimit të efektivitetit dhe të rezultateve në realizimin.

KODI I SJELLJES SË NËPUNËSVE QEVERTAR PËR MARRËDHËNIE ME OPINIONIN

Detyrimi themelor i komunikuesve qeveritar është t'ia transmetojnë opinionit qëndrimet dhe politikat zyrtare përmes kanaleve të ndryshme, gjë e cila paraqet një nga elementet kyç për demonstrim të hapjes, transparencës dhe llogaridhënies në punën e Qeverisë.

Përveç kësaj, komunikuesit qeveritar gjatë kohës së punës së tyre kanë qasje në informacione të besueshme dhe të ndjeshme, me të cilat duhet të procedohet në mënyrë përkatëse.

Gjatë komunikimit me opinionin, komunikuesit qeveritar duhet t'u përmbahen vlerave dhe rregullave, me të cilat sigurohet komunikim profesional, objektiv, efikas dhe i hapur me opinionin.

Prandaj përpiluam Kodin e sjelljes për komunikuesit qeveritar, në të cilin përfshihen standardet të cilat priten prej punëtorëve në sektorin publik që punojnë në komunikime.

Ky Kod i sjelljes së komunikuesve qeveritar i përshkruan parimet, standardet dhe praktikat e komunikimit përkatës me opinionin përmes kanaleve zyrtare të komunikimit, përfshirë edhe përmes kanaleve zyrtare dhe private të mediave sociale.

Ky Kod i sjelljes është i përgatitur në pajtim me kornizën ekzistuese ligjore në Republikën e Maqedonisë së Veriut, në të cilën është theksuar sjellja etike e cila pritet nga komunikuesit qeveritar (nëpunës publik dhe të kabinetit).

PARIME KYÇ

Nëpunësit publik dhe të kabineteve që punojnë në marrëdhëniet me opinionin duhet t'i përcjellin parimet vijuese për ta siguruar punën e tyre përkatëse:

- Ta thonë të vërtetën
- Të jenë të paanshëm
- Të jenë të kujdesshëm në qasjen e tyre
- Ta ruajnë objektivitetin
- Të sjellin vendime në bazë të analizës paraprake të fakteve
- Ti vënë obligimet që burojnë nga shërbimi para interesave personale
- Të jenë të vetëdijshëm për ekzistimin e konfliktit të interesave
- Ta ndajnë privaten nga veprimi profesional

Për atë qëllim, nevojitet që vazhdimisht të parashtrihen pyetjet vijuese:

- A është sjellja ime përkatëse?
- A do të kishin shkaktuar aktivitetet e mia eventualisht pyetje në lidhje me profesionalizmin tim, neutralitetin partiako-politik dhe paanshmërinë si nëpunës publik ose të kabinetit?

Në rast të dilemës në përgjigjet e këtyre pyetjeve, nevojitet konsultimi me eprorin.



COMBATING FAKE NEWS

Robert Popovski
 MINISTER WITHOUT PORTFOLIO IN THE GOVERNMENT OF THE REPUBLIC OF MACEDONIA IN CHARGE OF COMMUNICATIONS, ACCOUNTABILITY, AND TRANSPARENCY

Truth defies lies. Truth is a weapon, and fact checking is the tool. Veles has become a synonym for Fake News, let's make it a symbol to combat them.

Western Balkans Digital Summit
 Skopje 2018



БУЏЕТ 2019

ПОВЕЌЕ ПАРИ ЗА ГРАЃАНИТЕ

- Растечка економија
- Социјална праведност
- Подобра живејачка

Министерство за Финансији
 Република Македонија



MENAXHIM ME MEDIAT ZYRTARE SOCIALE SI KANALE ZYRTARE PËR KOMUNIKIM

HYRJE

Përhapja e mediave sociale dhe digjitale i mundëson Qeverisë që në mënyrë të drejtpërdrejtë dhe në mënyrë të dyanshme të komunikojë me qytetarët, të informohet për interesat e tyre dhe ta marrë parasysh mendimin gjatë krijimit dhe zbatimit të politikave qeveritare. Gjithnjë e më tepër qytetarë i shfrytëzojnë mediat sociale si mjet të informimit dhe prej aty nevoja për komunikim të shtuar me opinionin përmes mediave sociale për informim, e së këndejmi edhe nevoja për komunikim të shtuar përmes mediave zyrtare sociale të institucioneve. Qeveria ka për qëllim ta tërheqë dhe ta mbajë vëmendjen e qytetarëve përmes mediave sociale.



RREGULLA

- 1.** Nuk publikohen e as shpërndahen përmbajtje që do të mund të konsiderohen si fyese ndaj individëve ose ndaj një grupi të caktuar të qytetarëve
- 2.** Nuk publikohen e as nuk shpërndahen informacione, me të cilat do të ishin shkelur të drejtat autoriale të dikujt
- 3.** Nuk publikohen e as nuk shpërndahen informacione, me të cilat do të bëhej promovim selektiv ose favorizim i subjektit të caktuar juridik ose privat, me çka do të ndikohej në krijimin e konkurrencës jolojale
- 4.** Nuk publikohen e as nuk shpërndahen informacione, të cilat janë të klasifikuara ose që kanë status të tillë, ose informacione të cilat do t'i kishin ekspozuar kolegët e Juaj ose Ju personalisht në rrezik, pa dallim nëse bëhet fjalë për krim, terrorizëm ose spiunazh. Informatat për krim, terrorizëm ose spiunazh paraqiten te organi/institucioni përkatës ose te eprori
- 5.** Nuk publikohen e as nuk shpërndahen fotografi, në të cilat mund të dallohet identiteti i personit të mitur, duke mos marrë paraprakisht leje me shkrim nga prindërit/kujdestarët e tyre, përveçse kur ngjarja është publike ose në ambient të hapur
- 6.** Nuk publikohen e as nuk shpërndahen përmbajtje, për të cilat nuk jeni të sigurt a janë për opinionin. Në këtë rast duhet të kërkohet këshillë nga ndonjë koleg ose nga eprori
- 7.** Informacione të reja, të cilat për herë të parë nxirren në opinion, duhet fillimisht të publikohen në kanalet zyrtare të Qeverisë ose të përfaqësuesve më të lartë të institucioneve
- 8.** Nuk publikohen informacione të pasakta ose spekulime, me të cilat në çfarë do qoftë mënyre do të ishin sjellë qytetarët në hutë

UDHËZUES PËR PËRDORIMIN E KANALEVE PRIVATE TË MEDIAVE SOCIALE NGA KOMUNIKUESIT QEVERTARË

Gjatë menaxhimit me kanalet private në mediat sociale të komunikuesve të qeverisë, duhet të përcillen udhëzime të caktuara, që nuk bazohen në ndalesa, por në rregulla dhe rekomandime. Nuk duhet të ekzistojë ndalesë që të punësuarit t'i shfrytëzojnë mediat sociale, me atë që ka rregulla të caktuara.



RREGULLA

1. Publikimi i përmbajtjeve në emër personal mund të ndërlidhet me pozitën dhe institucionin në të cilin punon komunikuesi i qeverisë, përkatësisht, pozita e punës komunikuese qeveritare dhe privatësia e personalitetit vështirë mund të ndahen. Për këtë shkak, çdo përmbajtje e profilit personal mund të trajtohet dhe të jetë e perceptuar si qëndrim i institucionit, madje edhe në raste kur qëndrimi është i theksuar si personal. Duhet të merret parasysh nëse përmbajtja e shpërndarë mund të shkaktojë publicitet negativ dhe prishje të reputacionit të institucionit, në të cilin punon komunikuesi qeveritar.

2. Përmbajtjet e shpërndara në kanalet personale të mediave sociale, mund të mbeten publike, madje edhe nëse janë të shpërndara vetëm në kanale private dhe të mbyllura. Pjesëmarrja në diskutimet dhe aktivitetet eventuale politike ose publike, të cilat mund ta komprometojnë paanshmërinë e komunikuesit qeveritar, tërësisht duhet të shmangen.

3. Aktivitetet e komunikuesve qeveritar, si përfaqësues të pushtetit ekzekutiv, janë nën monitorim të veçantë nga shoqëria civile, nga subjektet politike dhe nga mediat, me çka matet sjellja e pushtetit ekzekutiv. Komunikimet jo përkatëse, të cilat përmbajnë përmbajtje diskriminuese, fyese, kërcënuese ose elemente të gjuhës së urrejtjes, mund të pasqyrohen si karakteristika të institucionit, të cilin e përfaqësojnë komunikuesit qeveritar. Publikimet e tilla gjithmonë duhet të shmangen.

4. Përmbajtjet e shpërndara përmes mediave sociale kanë rëndësi të njëjtë me përmbajtjet e shpërndara përmes cilit do qoftë medium tjetër tradicional ose elektronik. Rrjedhimisht, në kanalet private të mediave sociale duhet të shmangim:

- ♦ Promovim të anshmërisë partiake-politike
- ♦ Aktivitete të cilat shkaktojnë reputacion negativ për institucionin në të cilin punon komunikuesi qeveritar ose për institucion tjetër
- ♦ Informacione të pathëna deri në fund dhe të paqarta, të cilat lënë hapësirë për shpjegime të ndryshme ose kontekst të ndryshuar
- ♦ Fyerje, gjuhë e cila nxit urrejtje dhe diskriminim ose mund të kuptohet në atë mënyrë
- ♦ Publikimi i informacioneve të klasifikuara ose përmbajtje zyrtare, të cilat ende nuk janë të publikuara në opinion
- ♦ Pjesëmarrje në aktivitete joligjore ose sjellje jo përkatëse
- ♦ Shkelje e kushteve të cilat kanë të bëjnë me marrëdhënien e punës së komunikuesit qeveritar, në çfarë do qoftë mënyrë

5. Publikimi gjatë orarit të punës është joadekuat. Komunikuesit e qeverisë, njëlloj edhe si nëpunësit e tjerë publik dhe përfaqësues të institucioneve, kanë pozita dhe orar të punës të qasshëm në mënyrë publike. Çdo publikim i përmbajtjeve në mediat sociale gjatë orarit të punës mund të trajtohet si shmangie e detyrave të punës dhe me atë të shkaktojë reputacion negativ të institucionit, në të cilin punon komunikuesi qeveritar.



АПОСТОЛСКА ПОСЕТА НА ПАПАТА ФРАНЦИСК ВО РЕПУБЛИКА СЕВЕРНА МАКЕДОНИЈА

СКОПЈЕ
7 МАЈ 2019



Ова е историска можност!
Секој од нас треба да излезе и да донесе одлука!







Republika e Maqedonisë së Veriut

Qeveria e Republikës së Maqedonisë së Veriut



British Embassy
Skopje



Funded by
UK Government

IK Institute of
communication studies

 Government
Communication
Service

This product is prepared within the programme “Communication Strategy” funded by the UK Government with the support of the British Embassy Skopje. The content of this publication does not necessarily reflect the position or the opinions of the UK Government.

Овој производ е подготвен во рамки на проектот „Комуникациска Стратегија“ финансиран од Владата на Обединето Кралство, со поддршка на Британската амбасада Скопје. Мислењата и ставовите наведени во оваа содржина не ги одразуваат секогаш мислењата и ставовите на Британската Влада.

Ky produkt është përgatitur në kuadër të projektit Strategjia për Komunikim i financuar nga Qeveria e Mbretërisë së Bashkuar me mbështetjen e Ambasadës Britanike Shkup. Përmbajtja e këtij publikimi nuk pasqyron domosdoshmërisht qëndrimin ose mendimet e Qeverisë së Mbretërisë së Bashkuar.